

## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### Vendimi 2021-064

Data: 14.11.2021

#### Bashkëfinancimi për pjesëmarrjen e Meldin Mustafi në Development Championships 2021

- Aprovohet propozimi që trajneri Meldin Mustafi të udhëtojë me ekipin U14 në Development Championships 2021- Turqi në cilësinë e trajnerit.
- FTK do të ndihmojë me përkrahje financiare 20% të kostos së përgjithshme, ndërkaq pjesa tjetër e shpenzimeve do të mbulohet pjesërisht nga prindërit dhe vet trajneri.

### Vendimi 2021-065

Data: 14.11.2021

#### Përkrahje financiare për stërvitje përgatitore për ekipin U12/14 për Development Championship 2021

- Aprovohet propozimi për përkrahje financiare deri në 300 euro për terrenet e rezervuara për ushtrime përgatitore të ekipit U12/U14 për “Development Championships 2021”.
- FTK do të përkrahë financiarisht ekipet me kostot e terreneve të tenisit deri në 300 euro, ndërkohë që pagesat e trajnerëve do të mbesin përgjegjësi e prindërve.
- Ushtrimet e do të mbahen në Prizren për shkak të shumicës së lojtarëve që gjenden në Prizren, ndërkohë që lojtarët të cilët udhëtojnë nga vendet tjera do të përkrahen edhe me transport deri në max 20 EUR.

### Vendimi 2021-K02

Data: 12.11.2021

#### Përkrahje në infrastrukturë të K.T. Peja

- Kryetari Hadërgjonaj merr vendim të përkrahë financiarisht Klubin e Tenisit Peja për mbulimin e terreneve të tenisit në Karagaç-Pejë.
- FTK do të ndihmojë klubin me një vlerë prej tremijë euro ( 3,000 EUR), ndërsa klubi do të i ofrojë FTK-së dhe klubeve të tenisit në këmbim zhvillimin e aktiviteteve të tyre pa e ngarkuar me kosto financiare brenda periudhës sa zgjatë kontrata, për aktivitetet e tyre që përfshijnë turne, kampe, kurse, e të tjera, të cilat mund të e arrijnë vlerën deri në 1,500 EUR apo 50% të shumës totale të ndihmës nga ana e Federatës.

### Vendimi Nr. 2021-066

Data: 26.11.2021

Sezoni Dimëror 2021 – 2022

- Bordi me shumicë votash ka aprovuar rekomandimet e e administratës për mbështetje financiare të klubeve për sezonin dimëror 2021 – 2022.
- Klubet do të përfitojnë përkrahje sipas pikëve të grumbulluara për angazhimin e tyre dhe të qenurit aktiv brenda vitit si në vijim:

K.T. Peja	80 pikë
K.T. Prizreni	80 pikë
K.T. Rilindja	70 pikë
K.T. Gjakova	70 pikë
K.T. Hotshot	70 pikë
K.T. Sporek	50 pikë
K.T. Trepca	50 pikë
K.T. Kalaja	40 pikë
K.T. Diellix	40 pikë
K.T. Drenica	40 pikë
K.T. Prishtina	30 pikë
K.T. Arena	30 pikë
K.T. Bifurkacioni	20 pikë
K.T. Istogu	10 pikë
K.T. Vushtrria	10 pikë

- Përkrahjet financiare variojnë nga 200€ - 1700€, varësisht pikëve të grumbulluara, të cilat do të shpërndahen direkt në llogarinë e vendit përkatës ku do të zhvillohen ushtrimet dimërore, në baza mujore, pas pranimi të raporteve mujore dhe faturave përkatëse.

### Vendimi 2021-067

Data: 30.11.2021

Komisioni për përzgjedhjen e më të mirëve 2021

- Bazuar në pikën 2.2. të rregullores #06 për çmimet vjetore dhe shërbim ndaj sportit, bordi me shumicë votash miratuan propozimin që 1. Arben Islami, 2. Argjend Lecaj, 3. Genis Nallbani, të kontaktohen për tu angazhuar në komisionin për përzgjedhjen e më të mirëve të vitit 2021.
- Ky komision do të kontaktohet nga administrata e FTK-së.

### **Vendimi 2021-K03**

**Data: 30.11.2021**

#### **Nominimi për pjesëmarrje në komisionet e Tennis Europe**

- Bazuar në pikën 6.5 të statutit të FTK-së, bordi me shumicë votash ka miratuar propozimin që znj. Blerina Mati nënkryetare e FTK-së të jetë e nominuar nga federata për të qenë anëtare e komisionit për barazi gjinore dhe diversitet nga Komisionet funksionale të Tennis Europe.

- FTK do të nominoi znj. Mati për pjesëmarrje ndërkaq që përzgjedhja finale do të bëhet nga bordi i Tennis Europe.

### **Vendimi 2021-K04**

**Data:22.12.2021**

#### **Ndihmë në infrastrukturë për KT Kalaja**

- Kryetari Hadërgjonaj ka aprovuar kërkesën e KT Kalaja për ndihmë financiare për të mbuluar kostot për reflektor në terrenet e tensit në Landovic.
- FTK do të ofrojë 500 euro për reflektor për KT Kalaja, ndërkaq në këmbim KT Kalaja do të ofrojë gjithsejtë 35 orë në sezonin dimëror pa ngarkuar me kosto tenistët e dërguar nga FTK për stërvitje.